



KËSHILLI DREJTUES

**VENDIM QARKULLUES**

**Nr.13, datë 30.04.2020**

**Për miratimin e pasqyrave financiare të  
Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme  
për tremujorin e parë të mbyllur më 31 Mars 2020**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “m/1” të ligjit nr. 53/2014 “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar, nenit 71, pika 2, të nenit 73, pika 1, dhe të nenit 79, pika 1 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 15, pika 1 dhe pika 5 të Vendimit nr. 56, datë 3.10.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e Rregullores “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, të nenit 7, pika 6 dhe të nenit 8, pika 2, shkronja “l” të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë pasqyrat financiare të administrimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nga Agjencia, për tremujorin e parë të mbyllur më 31 Mars 2020, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për dërgimin e këtij vendimi dhe të pasqyrave bashkëlidhur në Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**